

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

**SCEL – 09 – 0012**

Punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore [REDACTED] në Gjakovë:

*Ankuesit*

01. [REDACTED] Krlevë, Republika e Serbisë  
Përfaqësuar nga avokati [REDACTED], Gjakovë
02. [REDACTED], Podgoricë, Mali i Zi  
Përfaqësuar nga avokati [REDACTED], Gjakovë
03. [REDACTED], Gjakovë  
Përfaqësuar nga avokati [REDACTED] Gjakovë

*kundër*

*I Padituri*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**  
Rr. Ilir Konushevcu Nr. 8, 10 000 Prishtinë

**Për: Avokatët e Ankuesve dhe të Paditurin**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (“Dhoma e Posaçme”), Trupi Gjykues, i përbërë nga Anna Bednarek si Gjyqtare Kryesuese, Antoinette Lepeltier-Durel dhe Sabri Halili, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 8 shtator 2010, lëshon këtë

### AKTGJYKIM

1. Ankesat e ankuesve [REDACTED] dhe [REDACTED] pranohen si të bazuara. I Padituri obligohet që t’i përfshijë ata në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore [REDACTED] në Gjakovë;
2. Ankesa e Ankuesit [REDACTED] refuzohet si e pabazë;
3. Agjencia Kosovare e Privatizimit është e obliguar që t’i paguajë ankuesve: [REDACTED] dhe [REDACTED] shumën prej 601,- (gjashtëqind e një) euro si kompensim për tarifën e avokatëve.

### Rrethanat procedurale:

Me 13 qershor 2009, ankuesi i parë [REDAKTUAR], i përfaqësuar nga avokati [REDAKTUAR] nga Gjakova, e parashtrori ankesën e tij në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me AKM-në kundër listës së punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore [REDAKTUAR] nga Gjakova. Në ankesën e tij, ai pohon se ai ka qenë punëtor në NSH-në e përmendur që nga viti 1975 deri më 12 qershor 1999, kur është larguar nga Gjakova për në Serbi si person i zhvendosur arsye sigurie. Ai saktëson se gjatë punësimit të tij, ai ka mbajtur disa poste, duke përfshirë edhe atë si Ushtrues i Drejtorit të Ndërmarrjes dhe, mu para zhvendosjes së tij, ai ishte Shef i Departamentit Komercial dhe Transaksionit të Pagesave (Financë). Sipas ankuesit, kur ishte publikuar lista, ai gjeti se emri i tij nuk ishte përfshirë, ndërsa 4 (katër) punëtorët e tjerë ishin përfshirë. [REDAKTUAR] gjithashtu thekson se ai nuk ishte në posedim të asnjë dokumenti për ta dëshmuar ankesën e tij, meqë të gjitha dokumentet kanë mbetur aty kur ai është dashur të largohet nga Gjakova, andaj ai ka propozuar që si dëshmitarë të dëgjohej punëtorët të cilët gjenden në listë. Me të përmbyllur ankesën e tij, Ankuesi kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me AKM-në që ta obligojë të Paditurën që t'ia njeh atij të drejtën në 20% të pjesës nga privatizimi se bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet gjyqësore.

Në bazë të Nenit 67.7 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, një kopje ankesës i ishte dërguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Më 23 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka paraqitur vërejtjet e saja me shkrim ndaj ankesës në gjuhën angleze dhe në gjuhën e ankuesit. Agjencia ka theksuar se ankuesi i parë ka paraqitur dëshmi me çka ka vërtetuar se ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore që nga viti 1975 deri më 12 qershor 1999, dhe se ai ia ka dërguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit një kopje të librezës së punës të hapur më 30 prill 1979, e cila është ende e hapur. Megjithatë, sipas të paditurit, nuk është sjellë asnjë dokument tjetër nga ky ankues që do ta dëshmonte vazhdimësinë e punësimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit duke iu referuar pretendimeve për diskriminim të bëra nga ankuesi, është përgjigjur se ai nuk e ka mbështetur ankesën e tij me prova materiale për diskriminim. Në veçanti, Agjencia Kosovare e Privatizimit u përgjigj se ankuesi nuk kishte treguar asnjë dëshmi se ai kishte ndërmarrë ndonjë hap që të kërkojë ndihmë nga autoritetet përkatëse përgjegjëse në atë kohë për sigurinë e njerëzve që jetojnë në Kosovë, (KFOR-i, Policia e UNMIK-ut) për të ofruar një siguri të tillë. Në fund, AKP-ja konsideron se [REDAKTUAR] nuk është regjistruar si punëtor në kohën e privatizimit të NSH-së, andaj edhe ankesa e tij duhet të refuzohet si e pabazë.

Me 7 dhjetor 2009, ankuesi i parë iu ka përgjigjur vërejtjeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke thënë se ato vërejtje janë të pabazuara. Ankuesi pohoi se ai ka paraqitur faktet mbi diskriminimin, dhe barra e provave se nuk ka pasur diskriminim bie mbi të paditurën, siç parashihet në Nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit 2004/3 të datës 19 shkurt 2004, dhe e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32. Ankuesi theksoi se librezat e punës mbyllet kur kontrata mbi punësimin ndërpritet dhe se këtu nuk ka ndodhur kështu, meqë nuk ka dokument me shkrim për ndërprerjen e punësimit. Gjithashtu dihet botërisht se pas datës 12 qershori 1999, vetëm 5 (pesë) gra të moshuara

dhe të sëmura kanë qëndruar në Gjakovë dhe se ato janë strehuar në godinat e Kishës Ortodokse. [REDAKTUAR] konsideron se punësimi i tij në NSH nuk është kontestues; sidoqoftë, kjo mund të vërtetohet nga Dhoma e Posaçme me dëgjimin e dëshmitarëve. Ankuesi e përfundon përgjigjen e tij duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta refuzojë pozicionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit si të pabazuar, dhe duke thënë se ai është i gatshëm të marr pjesë në seancën dëgjimore më kusht që gjykata do të merrej me masat e sigurisë.

Me 24 qershor 2009, ankuesi i dytë [REDAKTUAR] i përfaqësuar nga avokati [REDAKTUAR] nga Gjakova, e ka paraqitur ankesën e tij ku pretendon se ai ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore që nga viti 1975 deri me 12 qershor 1999, kur është shpërngulur nga Gjakova për në Serbi si person i zhvendosur për shkaqe sigurie. Ai saktëson se gjatë punësimit të tij, ai ka mbajtur disa poste brenda Ndërmarrjes, duke përfshirë pozitën si drejtor i kompanisë e mu para zhvendosjes së tij, në pozitën e Shefit të Departamentit Komercial dhe Transaksionit të Pagesave (Financë). Ai më tej theksoi se kur është publikuar lista, ai ka gjetur se emri i tij nuk është përfshirë, kurse 4 (katër) punëtorë të tjerë ishin përfshirë. Ankuesi gjithashtu thekson se ai nuk posedon asnjë dokument për ta dëshmuar ankesën e tij meqë të gjitha dokumentet i kanë mbetur aty kur ai është dashur të largohet nga Gjakova; andaj ai propozon që të dëgjohen ata punëtorë si dëshmitarë. [REDAKTUAR] kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me AKM-në që ta obligojë të paditurën që t'ia njeh atij të drejtën në 20% të pjesës nga privatizimi se bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet gjyqësore.

Në bazë të Nenit 67.7 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, një kopje ankesës i ishte dërguar AKP-së.

Më 06 korrik 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka paraqitur vërejtjet e saja me shkrim ndaj ankesës në gjuhën angleze dhe në gjuhën e ankuesit. Agjencia Kosovare e Privatizimit është përgjigjur se ankuesi i dytë ka paraqitur librezën e punës të hapur më 30 prill 1979, e cila është ende e hapur, megjithatë, sipas AKP-së, nuk është sjellë asnjë dokument tjetër nga ankuesi që do ta dëshmonte vazhdimësinë e punësimit. Sa i përket pohimeve të ankuesit lidhur me sigurinë personale, i padituri është përgjigjur se nuk ka asnjë dëshmi se [REDAKTUAR] ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor që të kërkojë nga autoritetet përgjegjëse në atë kohë për sigurinë e njerëzve që jetojnë në Kosovë, ( KFOR-it dhe/ose Policisë së UNMIK-ut), ndihmë për ofrimin e sigurisë së tillë. Duke iu referuar çështjes së diskriminimit, i padituri ka konsideruar se nuk kishte prova materiale për ta dëshmuar atë rrethanë. Në fund, Agjencia Kosovare e Privatizimit konsideron se ankuesi i dytë nuk ishte regjistruar si punëtor në kohën e privatizimit të NSH-së, andaj nuk ka pasur arsye që ai të përfshihej në listë dhe si pasojë vendosi se ankesa e tij duhet të refuzohet si e pabazë.

Më 7 dhjetor 2009, ankuesi i dytë iu ka përgjigjur vërejtjeve me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke thënë se ato vërejtje janë të pabaza. Ankuesi kishte pohuar se ai ka prezantuar fakte mbi diskriminimin, dhe barra e provave se nuk ka pasur diskriminim bie mbi të paditurin, siç parashihet në Nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit 2004/3 të datës 19 shkurt 2004, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32. Ankuesi theksoi se librezat e punës mbyllet atëherë kur kontrata mbi punësimin

ndërpritet dhe se këtu nuk ka ndodhur kështu, meqë nuk ka dokument me shkrim për ndërprejen e kontratës. Për më tepër, ai shpjegoi se gjithashtu dihet botërisht se pas datës 12 qershor 1999, vetëm 5 (pesë) gra të moshuara dhe të sëmura kanë qëndruar në Gjakovë dhe se ato janë strehuar në godinat e Kishës Ortodokse. [REDAKTUAR] konsideron se punësimi i tij në NSH nuk është kontestues; sidoqoftë, kjo mund të vërtetohet nga Dhoma e Posaçme me dëgjimin e dëshmitarëve. Ankuesi e përfundon përgjigjen e tij duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta refuzojë pozicionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit si të pabazuar, dhe duke thënë se ai është i gatshëm të marr pjesë në seancën dëgjimore më kusht që gjykata do të merrej me masat e sigurisë.

Më 3 korrik 2009, ankuesi i tretë [REDAKTUAR] i përfaqësuar nga avokati [REDAKTUAR] nga Gjakova, e ka paraqitur ankesën e tij me anë të së cilës konsideron se ka qenë punëtor i NSH-së në fjalë që nga viti 1979. Nga viti 1989 e deri në kohën e privatizimit ai ka qenë Drejtor i Përgjithshëm në NSH. Ankuesi më tej konsideron se pas konfliktit në vitin 1999, ndërtesa e Ndërmarrjes ishte shkatërruar, plaçkitur dhe pastaj e përdorur si strehë për personat e zhvendosur. Ai, si Drejtor Menaxhues i Ndërmarrjes, dhe në bashkëpunim me autoritetet e përkohshme komunale, kishte filluar prapë të punoi në NSH në mënyrë që ta për krijuar gjendjen e fakteve dhe kushtet e Ndërmarrjes. [REDAKTUAR] gjithashtu konsideron se ndërmarrja nuk ka punuar deri në kohën e privatizimit; andaj ai pyet se si këta katër punëtorë kanë mundur të futen në listë si punëtor. Sipas ankuesit lista është formuluar nga drejtori i vet-emëruar [REDAKTUAR], fillimisht si shitës në dyqan dhe pastaj si qiramarrës i një dyqani privat, dhe kolegët e tij të punës, pa ndonjë autorizim për ta përfaqësuar NSH-në ose nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Nga arsyet e mësipërme, [REDAKTUAR] pretendon se ka qenë i diskriminuar dhe se lista është formuar në mënyrë të joligjore nga të njëjtit persona të cilët e kanë futur veten në listë. Ankuesi theksoi se me 12 shtator 2007 ai ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit që ta rishikoi listën por ankesa e tij e paraqitur me 26 shtator 2007 nuk është marrë parasysh, meqë ai nuk ka marrë kurrfarë përgjigje nga Agjencia.

Në bazë të Nenit 67.7 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, një kopje ankesës i ishte dërguar Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Më 13 korrik 2009, i padituri i ka paraqitur vërejtjet e tij me shkrim ndaj ankesës në gjuhën angleze dhe në gjuhën e ankuesit. Agjencia Kosovare e Privatizimit ishte përgjigjur se [REDAKTUAR] në kohën e privatizimit ka qenë në moshën e pensionimit, meqë ka lindur me 5 prill 1938, andaj ka kaluar moshën 65 vjeçare, pra duke mos i përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Përveç kësaj, i padituri pohoi se ankuesi i tretë nuk ishte regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, prandaj ankesa e tij duhet refuzuar si a pabazuar.

Më 7 gusht 2009, [REDAKTUAR] iu ka përgjigjur vërejtjeve me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke thënë se ato vërejtje janë të pabazuara. Ai e kundërshtoi pretendimin për moshën e pensionimit, pasi që edhe një punëtor tjetër i përfshirë në listë, [REDAKTUAR], është më i vjetër se ankuesi. Më tej ai theksoi se kriteri i moshës së pensionimit nuk ishte i paraparë në Nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankuesi gjithashtu nënvizoi se Ndërmarrja pas vitit 1999 ishte shkatërruar dhe ishte

shfrytëzuar si strehim për personat e zhvendosur, prandaj nuk ka pasur mundësi që punëtorët të punojnë dhe nxjerrin të ardhura.

Më 7 korrik dhe më 4 gusht 2010, Dhoma e Posaçme mbajti seancat dëgjimore gjatë së cilave ankuesi i parë dhe i dytë u dëgjuan, si dhe dëshmitarët e treguar nga palët. Palët mbajtën qëndrimet e tyre të mëparshme.

Më datat 7 dhe 9 gusht 2010, përfaqësuesit e paditësve paraqitën listat e shpenzimeve.

Faktet:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e shpalli valën e 15-të të privatizimit përmes së cilës Ndërmarrja Shoqërore [REDAKTUAR] nga Gjakova ishte privatizuar me procedurën e rregullt spin off. Asetet dhe detyrimet ishin transferuar tek Kompania e Re L.L.C. Më datën 29 maj 2009, gjatë mbledhjes së 11-të të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është miratuar lista e përkohshme me 4 (katër) emra në të *(nuk është kundërshtuar)*.

Më 11, 12, dhe 13 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Serbe “Vijesti” nga Podgorica, Mali i Zi *(provë: nuk është kundërshtuar, kopjet e publikimeve)*.

Më 11, 13, dhe 14 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Serbe “Blic” nga Beogradi, Serbi *(provë: nuk është kundërshtuar, kopjet e publikimeve)*.

Më 11, 12 dhe 13 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Shqipe “Infopress” nga Prishtina *(provë: nuk është kundërshtuar, kopjet e publikimeve)*.

Më 11, 12 dhe 13 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Shqipe “Koha Ditore” nga Prishtina *(provë: nuk është kundërshtuar, kopjet e publikimeve)*.

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave pranë Dhomës së Posaçme, në pajtim me Nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ka kaluar më datën 4 korrik 2009. Dhoma e Posaçme i ka regjistruar 3 (tri) ankesa ku kërkohet përfshirja në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar të përpiluar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ankuesi [REDAKTUAR] (i lindur më 13 shtator 1952 në Mitrovicë) ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore të privatizuar [REDAKTUAR] në Gjakovë prej vitit 1976 deri në vitin 1999. Ankuesi ka punuar si zyrtar i prokurimit. Në vitin 1999 ai e braktisi Kosovën dhe shkoi me familjen e tij në Republikën e Serbisë për shkak të situatës së sigurisë. Pas konfliktit ai po bënte përpjekje që të kthehej në punë, mirëpo për arsye të sigurisë ai nuk mundi të kthehej. Libreza e punës së [REDAKTUAR] është e hapur që nga data 30 prill 1979. Ankuesi e vizitoi Gjakovën disa herë me autobusin e organizuar në mënyrë që t'i vizitonte varrezat. Ai nuk ishte i përfshirë në listën e punëtorëve të cilët i

kanë plotësuar kushtet për të marrë pjesën nga të ardhurat (provë: dëgjimi i ankuesit, dëgjimi i dëshmitarëve: [REDACTED], kopja e librezës së punës).

Ankuesi [REDACTED] (i lindur më 13 nëntor 1949) ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore të privatizuar [REDACTED] në Gjakovë prej datës 15 qershor 1977 deri në vitin 1999. Libreza e punës së tij është e hapur që nga data 30 prill 1979. Gjatë gjithë periudhës së punësimit në NSH pozita e tij ka qenë: farmacist bujqësor në njësinë e Rahovecit. Në qershor të vitit 1999 ai e braktisi Gjakovën dhe shkoi në Podgoricë (Mal të Zi) për shkaqe sigurie. Pas luftës, banesa e tij ishte uzurpuar nga persona të tjerë, të cilët ishin të panjohur për ankuesin (provë: dëgjimi i ankuesit, dëgjimi i dëshmitarëve: [REDACTED], kopja e librezës së punës).

Ankuesi [REDACTED] (i lindur më 5 prill 1938 në Gjakovë) ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore të privatizuar [REDACTED] në Gjakovë prej datës 7 mars 1979, deri më datën 13 gusht 1997. Pozita e ankuesit në NSH ishte: drejtor. Në një datë të mëvonshme, punësimi me NSH-në ishte përfunduar për shkak të faktit se ankuesi ishte shpallur si invalid i kategorisë së parë si pasojë e sëmundjes. [REDACTED] merr pension mujor në shumën prej 35 (tridhjetë e pesë) eurove që nga data 3 prill 2003 (provë: dëgjimi i dëshmitarëve: [REDACTED]; dokumentet: "Kërkesa për të dhënat" e datës 28.01.1998, "Kërkesa për pagesën e kontributeve" e datës 23.02.1998, "Vendimi mbi ndërprerjen e punësimit me qëllim që të pensionohet si invalid" i datës 11.02.1998, "Vendimi mbi aplikimin për pensionin bazë" i datës 24 prill 2003).

Më 24 mars 1999, kur filloi bombardimi, së bashku me ankuesit [REDACTED] dhe [REDACTED] gjithashtu kishte edhe persona të tjerë që punuan për NSH-në si [REDACTED] (prej vitit 1987), [REDACTED] (prej vitit 1976) si dhe të tjerë (provë: dëgjimi i dëshmitarëve: [REDACTED]).

Ndërmarrja Shoqërore [REDACTED] në Gjakovë nuk ishte operacionale pas qershorit të vitit 1999 dhe se kurrë nuk ka filluar punën pas luftës. Lokalet e NSH-së ishin shkatërruar dhe pajisjet mungonin. Fillimisht pesë (duke përfshirë ankuesin [REDACTED]) dhe rrjedhimisht vetëm katër nga punëtorët që ka punuar më parë në Ndërmarrje kishin ardhur në lokalet pas qershorit të vitit 1999 duke u përpjekur që të fillonin ta bënë NSH-në operacionale. Ata nuk kanë marrë asnjë rrogë (provë: nuk janë kundërshtuar nga palët, dëgjimi i dëshmitarëve [REDACTED]).

Dhoma e Posaçme vendosi lidhur me faktet e mësipërme në bazë të dëshmive të mbledhura gjatë procedurës gjyqësore: dëgjimi i dëshmitarëve dhe të palëve, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga të dyja palët dhe jo të kontestuara nga ato kundërshtarë. Gjykata i vlerësoi deklaratat e ankuesve: [REDACTED] dhe [REDACTED] si shumë të besueshme dhe në përputhje me dëshmitë e tjera të mbledhura gjatë procedurës gjyqësore, dhe posaçërisht me deklaratat e dëshmitarëve. Ankuesit i përshkruan faktet në një mënyrë shumë të qartë dhe të hollësishme. Përshkrimi i gjendjes faktike nga ana e tyre i përgjigjej njohurive të përgjithshme për sa i përket situatës

së sigurisë në Kosovë pas konfliktit si dhe raporteve të cilat gjendeshin në deklarata e dëshmitarëve.

Trupi Gjykues i vlerësoi deklaratat e dëshmitarëve:

[REDAKTUAR] si të besueshme në lidhje me faktet e vendosura. Në fakt ata të gjithë i konfirmuan llogaritë e dëshmitarëve të tjerë dhe së bashku përbënë një pasqyrë të qartë të situatës në të cilën gjendej Ndërmarrja para dhe pas luftës. Në pjesët e mbetura të deklaratave të dëshmitarëve e cila nuk ishte pasqyruar në gjendjen e vendosur faktike (p.sh. lajmërimi nga ana e dëshmitarëve në Ministrinë e Bujqësisë çdo ditë) Dhoma e Posaçme e gjeti si të paarsyeshme dhe vështirë të besueshme. Për sa i përket rrethanës së lajmërimit nga ana e punëtorëve pas luftës, deklarata e dëshmitares [REDAKTUAR] ishte për më tepër në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit [REDAKTUAR], i cili hollësisht shpjegoi se “nuk ka pasur administratë për t’u lajmëruar”.

### Arsyetimi ligjor

Neni 67.10 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thekson: “Seanca gojore mbahet nëse ankuesi ose i padituri kërkon me shkrim që ajo të mbahet. Paneli Gjykues mund të vendosë se a do të mbajë seancë gojore. Nëse mbahet seanca gojore, Paneli Gjykues e njofton me shkrim ankuesin dhe Agjencinë për datën e mbajtjes së seancës.”

Pasi që të gjithë Ankuesit parashtruan një kërkesë për një seancë gojore, prandaj në pajtim me Nenin 67.10 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme vendosi të vazhdojë me seancën për dëgjimin e provave më 7 korrik 2010 dhe seancën e fundit dëgjimore më 4 gusht 2010.

Në bazë të Nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në pronësi Shoqërore “të punësuarit në ndërmarrjet shoqërore kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20 për qind e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një filiali korporate në varësi të një ndërmarrjeje me pronësi shoqërore, që është privatizuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12. Shuma ndahet në dobi të të punësuarve me të drejta legjitime në përputhje me këtë nen.”

Në bazë të Nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13:

“Lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6, publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetatat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetatat kryesore në gjuhën serbe.”

Procedura për parashtrimin e një ankese pranë Dhomës së Posaçme rregullohet nga Nenin 10.6 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i cili thekson se “Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime”. Meqë publikimi i listës u shpall më 14 qershor të vitit 2009, dita e fundit për parashtrimin e ankesave pranë Dhomës së Posaçme ishte më datën 4 korrik 2009.

Ankesat e të tre ankuesve [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED] ishin parashtruar me kohë (përkatësisht në datat 13 qershor, 24 qershor dhe 3 korrik 2009).

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/45 i përcakton kërkesat në mënyrë që një punëtor të konsiderohet se ka të drejta: “Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.”

Ankuesit i kërkuan Dhomës së Posaçme që t’i përfshijë ata në listën zyrtare të punëtorëve me të drejta legjitime në ndarjen e 20% nga të ardhurat prej shitjes së pjesëve të marra gjatë privatizimi të Ndërmarrjes Shoqërore [REDACTED] në Gjakovë. Ankuesi i parë dhe i dytë gjithashtu pohuan se lista nuk ishte krijuar në mënyrën e duhur, pasi që ata ishin diskriminuar për shkak të etnitetit të tyre serb.

Dhoma e Posaçme gjen se ankuesit [REDACTED] dhe [REDACTED] i përmbushin kërkesat e Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar dhe se ankesat e tyre pranohen si të bazuara për shkak të arsyeshme të mëposhtme.

Fillimisht duhet të sqarohet se çështja e diskriminimit të punëtorëve është e rregulluar në Rregulloren e UNMIK-ut 200/13. Neni 10.4 thekson se kërkesa për të qenë një punëtor i regjistruar pranë NSH-së në kohën e privatizimit dhe jo më pak se 3 vite nëse ka qenë në listën e pagave të NSH-së “nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar”. Neni 10.6 (b) thekson se “Çfarëdo ankese e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimin si shkak për mos-përfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar.”

Megjithatë, në mënyrë që të parandalohet diskriminimi dhe të promovohet dhe të vihet në zbatim parimi i trajtimit të barabartë e qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30.07.2004, e miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit 2004/3 (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/32)).

Neni 11.1 i Ligjit të njëjtë thekson: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë”. Në Nenin 11.2 theksohet se “Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.”

Prandaj dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit zëvendësojnë dispozitat lidhur me barrën e provave të nevojshme që të vërtetojnë diskriminimin siç theksohet të Nenit 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Në pajtim me Nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit personat të cilët pretendojnë për diskriminim duhet të paraqesin faktet nga

të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Përveç kësaj, pasi që ankuesi e paraqet një rasat *prima facie* të diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i Padituri duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim.

Ankuesi i parë dhe i dytë nënvizuan se ata ishin diskriminuar për shkak të etnisë së tyre serbe. Ndërsa në anën tjetër i padituri pohoi se ata nuk kanë parashtruar ndonjë dëshmi që do të vërtetonte deklaratat e ankuesve. Pavarësisht këtij fakti, ky është një obligim i të paditurit për të vërtetuar se ka qenë e kundërta nga ajo se çfarë ankuesit kanë deklaruar, situata në Kosovë pas konfliktit ka qenë e ditur në përgjithësi.

Në bazë të Nenit 221 paragrafit 4 të Kodit mbi Procedurën Kontestimore (7/77-1478 I ndryshuar) “Faktet të cilat janë çështje e njohurive të përgjithshme nuk kanë nevojë që të vërtetohen”.

Dhoma e Posaçme dëshiron të nënvizojë se janë disa raporte të paraqitura nga Organizata Qeveritare dhe Joqeveritare të ndryshme të cilat e kanë përshkruar situatën e sigurisë në Ballkan dhe në veçanti në Kosovë. Si një shembull mund të citohet raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave i datës 6 gusht 1999: “Nuk kalon asnjë ditë pa së paku një raportim të sulmit në disa pjesëtarë të minoriteteve në Kosovë. Komuniteti serb dhe romë (ciganët) janë më të pambrojturit, por në cak janë edhe pjesëtarët e komunitetit goran, boshnjak dhe të shumicës shqiptare. Sulmet përfshijnë djegiet e shtëpive, sulmet fizike dhe vrasjet. (...) Këto sulme janë aq të përhapura sa që disa vëzhgues po spekulojnë se është një fushatë e organizuar me qëllim të krijimit të një Kosove të pastër etnikisht shqiptare.”

Gjithashtu, raporti i Amnesty International, organizatë joqeveritare e cila vepron në fushën e të drejtave të njeriut, i publikuar në nëntor të vitit 1999 thotë si vijon: “atmosfera e mungesës së tolerancës në Kosovë e karakterizuar nga frikësimi, ngacmimi dhe diskriminimi ka rezultuar në një kufizim të rëndë të lirisë së lëvizjes dhe ka penguar qasjen në shërbimet kryesore si shërbimi shëndetësor, edukimi, për shumë komunitete në pakicë. Viktimat e këtyre abuzimeve janë shpesh të moshuarit ose personat e sëmurë të cilët nuk kanë mundësi, apo nuk dëshirojnë të largohen nga shtëpitë e tyre.”

Në qershor të vitit 2009 Amnesty International publikoi raportin “Groposja e së kaluarës” ku në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë thuhej: “Nga marsi deri në qershor 1999, mbi 3,000 shqiptarë etnikë ishin viktimat e zhdukjes me forcë nga policia e paraushtarakët serbë dhe forcat ushtarake jugosllave. Në vijim të luftës afro 800 serbë, romë dhe anëtarë të grupeve të tjera në pakicë u rrëmbyen nga kosovarët-shqiptarë, përshirë këtu dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. (...) Shumë prej serbëve të cilët qëndruan në Kosovë pasi u larguan VJ-ja (Vojska Jugosllavije – Ushtria Jugosllave) dhe policia serbe, vepruan kështu pasi besuan se KFOR-i dhe UNMIK-u do t’i mbronte. Shumë prej tyre u rrëmbyen dhe u vranë para syve të KFOR-it.”

Ankuesi [REDAKTUAR] filloi të punojë pranë NSH-së në vitin 1975 dhe punoi aty deri në muajin qershor të vitit 1999. Libreza e tij e punës është ende e hapur. Ankuesi [REDAKTUAR] filloi të punojë në “Stacionin Bujqësor” në Gjakovë më 15 korrik 1997 dhe punoi aty deri në muajin qershor të vitit 1999. Libreza e tij e punës është ende e hapur.

Rrethana që ankuesit kanë punuar në NSH deri në kohën kur filloi lufta nuk ishte vënë në pikëpyetje nga i padituri: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Megjithatë AKP-ja theksoi se ankuesit nuk kanë parashtruar ndonjë dëshmi dokumentuese e cila do të vërtetonte punësimin e tyre nga 30 prilli i vitit 1979 dhe 1999. Por në të njëjtën kohë nuk ka thekuar se çfarë lloj provash ata do të pranohin si vërtetim të vazhdimësisë së punësimit. Dhoma e Posaçme vlerëson se librezat e punës pasqyrojnë gjendjen faktike të punëtorit të caktuar dhe nëse pala e kundërt është e mendimit se dokumenti nuk i pasqyron faktet, ajo palë e bartë barrën e provës se rrethanat kanë qenë të ndryshme nga ato të vërtetuara nga dokumenti i dorëzuar. Prandaj nuk i takon ankuesit të vërtetojë se dëshmia dokumentuese e parashtruar nga ai nuk është ajo e cila duhet të merret parasysh gjatë vërtetimit të fakteve. Pretendimi i të paditurit në fakt ka qenë i drejtuar për transferimin e barrës së provës nga AKP-ja tek ankuesit. Një arsyetim i tillë nuk mund të ndahet nga Gjykata pasi që është në kundërshtim me përmbajtjen e Nenit 219 të Kodit mbi Procedurën Kontestimore i cili thekson se: “Secila palë ka për detyrë të paraqes fakte dhe të propozojë prova, në të cilat e bazon kërkesën e vet, apo me të cilat i kundërshton thëniet dhe provat e kundërshtarit”. Dokumentet e parashtruara nga ankuesit, në bazë të Nenit 230 të KPK-së dëshmojnë vërtetësinë e asaj çfarë theksohet në to. Me qëllim të vlerësimit të librezës së punës dhe përmbajtjes së saj, duhet të nënvizohet, se fakti që ankuesit i kanë mbajtur ato pas qershorit të vitit 1999 librezat e tyre të punës përkatëse nuk janë të rëndësishme për aktvendimin e lëndës në fjalë, pasi që ka qenë detyrë e të paditurit, si administrator i NSH-së me posedimin e të gjitha dokumentet e saj, për të treguar se librezat e punës është dashur të pasqyrojnë faktet e tjera lidhur me marrëdhënien e punës së ankuesve pranë Ndërmarrjes. Ankuesit vetë nuk ishin në dijeni për çfarëdo dokumente për sa i përket kësaj dhe rrjedhimisht nuk kanë mundur që të parashtrorjnë ndonjë dokument tjetër të kërkuar nga i padituri. Në anën tjetër, duke pasur parasysh se NSH-ja nuk ka punuar pas luftës dhe se nuk kishte autoritet që do të vendoste çfarëdo shënime në librezën e punës e bëjnë pretendimin e të paditurit të pabazë dhe pa asnjë rëndësi me qëllim të vendosjes për faktet në lëndën në fjalë.

I padituri pohoi se ankuesit nuk e kanë vërtetuar vazhdimin e punësimit të tij pranë NSH-së pas luftës. Duke pasur parasysh faktin se Ndërmarrja Shoqërore në fjalë fare nuk kishte operuar pas luftës së vitit 1999 (faktet e përshkruara nga dy ankuesit të dëgjuar nga Gjykata dhe të gjithë dëshmitarët, edhe ata të cilët tashmë kishin marrë 20% të të ardhurave nga shitja e pjesëve) dhe fakti se lista e pagave si e tillë kurrë nuk ishte hartuar pas qershorit të vitit 1999, ky pretendim i të paditurit mund të vlerësohet vetëm si i palogjikshëm dhe fare bindës. Autoriteti publik me ushtrimin e obligimeve të veta nuk mund ta interpretojë ligjin në një mënyrë që është në kundërshtim me njohuritë e përgjithshme dhe i cili synon dëmtimin e qytetarëve. Kërkesa e ligjit e cila kërkon që punëtori të jetë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tre vite ka nevojë të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe derisa të analizohet duhet t'i referohet gjendjes faktike të ndërmarrjes në fjalë. Nga konkluzioni duhet të vihet në përfundim që Gjykata duhet të shqyrtojë nëse punëtori ishte i përfshirë në listën e pagave kur ishte ende duke u përgatitur nga NSH-ja. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në fakt ishin në listën e pagave të Ndërmarrjes deri në muajin qershor të vitit 1999 dhe se kjo kërkesë për sa i përket ankuesit të parë dhe të dytë është përmbushur. Gjykata është e mendimit se nuk mund të kërkohet që pala të jetë në listën e pagave e cila nuk ekziston në kohën e privatizimit.

E njëjta i referohet pretendimit të ngritur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit se ankuesit nuk ishin të regjistruar si punëtorë në NSH në kohën e privatizimit. Meqenëse NSH-ja nuk ka qenë operationale pas konfliktit në vitin 1999 dhe nuk mund të flitet për punëtorët e ndryshëm nga ata të regjistruar në Ndërmarrjen përderisa ajo ishte ende operationale. Dhoma e Posaçme është e mendimit se ata punëtor të cilët ishin regjistruar para muajit mars të vitit 1999 duhet të konsiderohen si punëtorët e regjistruar në kohën e privatizimit. Vetëm fakti se disa nga punëtorët ndërmorën hapa në mënyrë që ta bënin Ndërmarrjen operationale pas muajit qershor të vitit 1999, por pa ndonjë rezultat pozitiv, nuk e bën pozitën e atyre punëtorëve ndryshe nga ata të cilët nuk kanë marrë pjesë në ato përpjekje. Gjykata e pranon se kërkesa e regjistrimit pranë NSH-së nuk mund të nënkuptohet që të jetë e përmbushur vetëm në rastet e atyre punëtorëve të cilët raportuan se ata po ndërmerrnin masa në mënyrë që ta bënin vendin e tyre të mëparshëm të punës që të funksionojë dhe se ajo duhej të vlerësohej si i vetmi kusht që të përfshihen ata persona në listën e punëtorëve të kualifikuar. Në fakt në rastin e NSH-së se pas luftës përballet me vështirësi si për shembull: mungesën e lokaleve ose lokalet e dëmtuara, mungesa e pajisjeve dhe e dokumentacionit, organet e pa konstituara, mungesa e operationeve efektive, pozita e punëtorëve të cilët nuk ishin në gjendje që të ktheheshin në qytet ku më parë Ndërmarrja e kishte selinë për arsye sigurie dhe pozita e atyre punëtorëve të cilët nuk kishin arritur ndonjë rezultat derisa përpiqeshin ta krijonin vendin e tyre të punës, nuk ndryshon për qëllimet e zbatimit të Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Pretendimet e të paditurit se NSH-ja ishte regjistruar në regjistrat e UNMIK-ut, pasi që nuk ishte fare e mundur për Stacionin Bujqësor që të operonte, mbetet krejtësisht i parëndësishëm për përmbajtjen e aktvendimit të prerë për lëndën në fjalë.

Për më tepër, duhet të theksohet se gjatë procedurës gjyqësore është vërtetuar se ankuesit pas muajit qershor të vitit 1999 ishin larguar nga Gjakova për arsye sigurie, përkatësisht në Serbi dhe Mal të Zi, si persona të zhvendosur dhe që nga atëherë ata nuk kanë qenë në gjendje që të kthehen në punë. AKP-ja pohoi se provat e paraqitura nuk ishin të mjaftueshme për të vërtetuar se ankuesit ishin diskriminuar, ata nuk mund të ktheheshin dhe se ata ishin regjistruar si punëtor pas muajit qershor të vitit 1999. Ky argument i të paditurit nuk mund të pranohet sepse librezat e punësimit janë ende të hapura dhe se i padituri nuk ka paraqitur asnjë dokument që do ta çonte Gjykatën në përfundimin se librezat e punës do të duhej të përmbante një shënim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa situata e dobët e sigurisë në Kosovë në vitin 1999 dhe liria e kufizuar lëvizjes për anëtarët e etniteteve në Kosovë pas vitit 1999 janë fakte famëkeqe të cilat nuk ka nevojë që të vërtetohen. Dhoma e Posaçme ka vendosur se ankuesit kanë punuar në NSH, përkatësisht nga 30 prilli i vitit 1979 deri më 15 korrik të vitit 1977<sup>1</sup> derisa filloi konflikti. Prandaj, Dhoma e Posaçme gjen se në bazë të provave të paraqitura ankuesit kanë qenë në listën e pagave për më tepër se 3 vjet dhe se ende ishin të regjistruar pranë NSH-së në kohën e privatizimit, librezat e tyre të punës kurrë nuk ishin mbyllur.

<sup>1</sup> Translator's note: I think that the year is not correct!

Për sa i përket pretendimit të ngritur nga ankuesit se ata ishin diskriminuar duhet të theksohet se në bazë të Ligjit mbi Diskriminimin të cituar më lartë, se barra e provës e asaj rrethane i takon të paditurit. I takon të paditurit të vërtetojë se ankuesit nuk ishin diskriminuar. Pasi që i padituri nuk ka paraqitur asnjë provë për t'i hedhur poshtë deklaratat e ankuesve, Dhoma e Posaçme qëndron pas asaj se dispozita e Nenit 10.4 e Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 është drejtpërdrejt e zbatueshme për [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Në këtë drejtim duhet që gjithashtu të theksohet se Gjykata nuk e ka gjetur si të arsyeshme sugjerimin për t'iu kërkuar ankuesve prova të mëtutjeshme për sa i përket diskriminimit dhe Dhoma e Posaçme nuk e ka miratuar atë kërkesë. Si pasojë e kësaj, Gjykata vlerësoi se ankuesit nuk ishin përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar për arsye të diskriminimit.

Ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] refuzohet si e papranueshme. Ankuesi nuk i përmbush kërkesat nga Neni 10.4 të RREG së UNMIK-ut që rrjedhimisht janë ndryshuar.

Ankuesi i tretë ka punuar për Ndërmarrjen Shoqërore "[REDAKTUAR]" në Gjakovë që nga 7 marsi i vitit 1979. [REDAKTUAR] e ndërpreu punësimin me NSH-në më 13 gusht të vitit 1997. Në atë ditë ankuesi ishte shpallur si invalid i kategorisë së parë si pasojë e sëmundjes. Ajo gjendje ishte vërtetuar nga dëshmitarët e dëgjuar nga Gjykata, si dhe nga dokumentet e parashtruara nga [REDAKTUAR]; letra e cila e bartë nënshkrimin e vetë ankuesit, i cili i kishte shkruar NSH-së dhe duke kërkuar pagesën e kontributeve për të ardhurat personale për vitet nga 1995 deri në 1998. Dokumentet, dhe deklaratat e dëshmitarëve tregojnë, se edhe pse librezat e punës e ankuesit të tretë është ende e hapur, në bazë të dokumenteve të dorëzuara, do të duhet të ishte përfshirë shënimi lidhur me ndërprerjen e punësimit tashmë në vitin 1997. Kjo domethënë se në ditën e privatizimit ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave të NSH-së. Fakti se marrëdhënia e punës në mes të ankuesit dhe NSH-së ishte ndërprerë pothuajse 2 vjet para konfliktit e përjashton atë prej grupit të atyre punëtorëve me të drejta. Kërkesat e përcaktuara në Nenin 10.4: regjistrimi si punëtor në kohën e privatizimit dhe të qenit në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vjet do të duhej të përmbushen që të dyja në lidhje me njëra tjetrën. Ligjvënësi, duke përdorur fjalën "dhe" tregon se të dyja kushtet do të duhej të përmbusheshin bashkërisht, në mënyrë kumulative. Prandaj, ankuesi edhe pse ka punuar për më tepër se tri vjet me Ndërmarrjen e privatizuar, ai nuk mund të përfshihet në listë, pasi që ai nuk ishte në listën e pagave tashmë gati për 2 vjet para konfliktit dhe para se Ndërmarrja ndaloi të qenit operacionale dhe gati 8 vjet para kohës së privatizimit. Si rrjedhojë e kësaj, [REDAKTUAR] nuk i përmbushë kërkesat ligjore për përfshirjen në listën e punëtorëve të kualifikuar që të marrin pjesët nga procesi i privatizimit dhe likuidimit dhe se ankesa e tij duhet të refuzohet.

Meqenëse asnjëra nga palët nuk ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme t'i vërtetojë arsyet e përfshirjes së personave emrat e të cilëve gjenden në listë, vërtetimi në atë drejtim nuk ishte kryer nga Gjykata në bazë të Nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

## Shpenzimet

Në bazë të Nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, Trupi Gjykses duhet të vendosë lidhur me ndarjen e shpenzimeve të proceseve gjyqësore në lëndë. Në bazë të Rregullave Procedurale Shtesë të Dhomës së Posaçme lidhur me Taksat Gjyqësore në fuqi që nga 10 marsi i vitit 2010 (në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) procedurat gjyqësore në lëndët lidhur me Listat e Punëtorëve të Kualifikuar (Neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6) janë pa pagesë për sa i përket taksave gjyqësore.

Duhet megjithatë të nënvizohet se në bazë të Nenit 57 të UA të UNMIK-ut 2008/6 “llogaritja e shpenzimeve do të duhej të përfshinte shpenzimet e gjyqit, honorarët e arsyeshëm të avokatëve, kompensimi për humbjen e rrogës së dëshmitarëve, honorarët e arsyeshme të ekspertëve, shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, që janë shkaktuar”.

Fakti që Gjykata nuk kërkon që pala t'i paguajë shpenzimet e gjyqit nuk do të thotë se shpenzimet lidhur me pagesën për avokatin i cili e ka përfaqësuar palën e liruar nga shpenzimet e gjyqit, nuk duhet të mbulohet nga pala e pasuksesshme. Gjykata vetëm mundet ta lirojë palën nga pagesa e shpenzimeve të gjyqit dhe kurrë nuk mund ta lirojë palën nga detyrimi për t'i kompensuar shpenzimet e ndihmës gjyqësore nga ndonjë avokat profesional.

Pasi që Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka humbur rastin për sa i përket dy ankuesve të parë, është e obliguar që t'i kompensojë ata ankues lidhur me shpenzimet e arsyeshme për avokatin. Përfaqësuesi i të dy ankuesve të parë e parashtrroi një listë të shpenzimeve nga e cila shihet se shpenzimet e procedurës së tanishme gjyqësore janë 601 (gjashtëqind e një) euro për secilin ankues. Për këtë arsye Dhoma e Posaçme e urdhëroi Agjencinë Kosovare të Privatizimit që ta paguajë shumën e cekur më lartë për ankuesin e parë dhe të dytë.

Ankuesi i tretë: ██████████ është pala e pasuksesshme dhe andaj nuk ka të drejtë që të kompensohen shpenzimet e avokatit të tij. I padituri, i cili e ka fituar rastin, nuk ishte i përfaqësuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe se nuk ka të drejtë që ta marr kompensimin e shpenzimeve të avokatit.

Për shkak të gjitha arsyeve të përmendura më lartë, Dhoma e Posaçme vendosi si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet me shkrim pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi.

Anna Bednarek Gjyqtare Kryesuese e EULEX-it	nënshkrimi
Antoinette Lepeltier-Durel Gjyqtare e EULEX-it	nënshkrimi
Sabri Halili, Gjyqtar	nënshkrimi
Tobias Lapke Regjistruer i EULEX-it	nënshkrimi